



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

PRISHTINA



Komuna e Prishtinës
Opština Priština - Municipality of Prishtina

18. 02. 2015

REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA E PRISHTINES - OPSTINA PRISTINE

01-031-40750

Nr./Br.

Dl.



Datë/a:	16 shkurt 2015
Referenc-ë:	
Për/ Za/ To:	Këshilltarët e Kuvendit Komunal të Prishtinës
CC:	Z. Besnik Osmani, Sekretar, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal z. Agron Maxhuni, Departamenti ligjor, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Përmes/Preko/Through:	Halim Halimi, Kryesues i Kuvendit Komunal të Prishtinës
Nga/ Od/ From:	Shpend Ahmeti, Kryetar i Komunës së Prishtinës
Tema/ Subjekat/Subject:	Shqyrtim i aktit komunal

I nderuari Z. Halimi,

Të premten, me datën 13 shkurt kam pranuar nga zyra e sekretarisë së Kuvendit disa vendime të cilat thuhet se janë marrë në mbledhjen e Kuvendit Komunal me 5 shkurt 2015.

Në bazë të nenit 58, pika k, të Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, dhe duke qenë përgjegjës për zbatimin e vendimeve të organeve të Komunës së Prishtinës, kërkoj nga Kuvendi Komunal të shqyrtohen vendimet e datës 5 shkurt 2015, në cilësinë e akteve komunale për shkak se të njëjtat cenojnë legjislacionin në fuqi për arsyet e poshtëshënuara.

1. Në seancën e fundit të Kuvendit Komunal të mbajtur me datën 5 shkurt 2015, pas shqyrtimit të futjes në rend të ditës të një pike të propozuar nga Lirak Çelaj, ju seancën e keni ndërprerë. Mirëpo, duke anashkaluar të gjitha dispozitat që përcaktojnë thirrjen e një mbledhje të rregullt apo edhe të jashtëzakonshme, jemi njoftuar se grupet e këshilltarëve të Kuvendit Komunal nga radhët e LDK-së dhe PDK-së, rreth orës 14:00 janë mbledhur brenda sallës së këtij organi dhe kanë marrë vendime të caktuara. Subjektet e tjera politike kanë dërguar letër ku kanë kërkuar shtyrjen duke potencuar se nuk janë njoftuar për vazhdimin e seancës.

Neni 43, paragrafi 3 i Ligjit 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale përcakton qartë se anëtarët e këtij organi legjislativ duhet të njoftohen paraprakisht me shkrim shtatë (7) ditë para mbajtjes së seancës së rregullt. Gjithashtu, dispozita ligjore pasuese e po këtij ligji, që ndërlidhet me mbledhjet e jashtëzakonshme,

përkatësisht neni 44, paragrafi 1 kushtëzon mbajtjen e një mbledhje të tillë me kërkesën e bërë me shkrim nga së paku një e treta e numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këtij organi. Tutje, për mbledhjen e jashtëzakonshme paragrafi 4 i nenit 44 të ligjit të lartëcekur kërkon që anëtarët e këtij organi dhe publiku duhet të njoftohen së paku tre (3) ditë para mbajtjes së kësaj mbledhje.

2. Në lidhje me vendimet për aksionarët e ndërmarrjeve publike, në mbështetje të mbrojtjes së ligjshmërisë kundrejt vendimeve që mund të dalin nga Kuvendi Komunal i Prishtinës, duhet të ritheksojmë ashtu siç edhe e kemi kërkuar në fillim të mbajtjes së kësaj seancë të këtij organi, se kërkesat e parashtruara nga z. Ylli Hoxha, asambleist i këtij organi në lidhje me konfliktet e interesit për nëntë (9) anëtarë të këtij organi. Ju, keni qenë i obliguar në bazë të nenin 38 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale dhe nenit 5 mbi fushëveprimin e Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, të veproni duke, së paku shqyrtuar, ashtu që të parandaloni votimin e anëtarëve në konflikt interesi, veprim të cilin nuk e keni ndërmarrë.

Neni 38 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale përcakton se

“38.1 Anëtari i kuvendit të komunës apo anëtari i komitetit nuk mund të jetë pjesëmarrës në marrjen e vendimeve dhe në procedurat administrative që kanë të bëjnë me cilëndo çështje në të cilën ai ose ajo, apo ndonjë anëtar i afërt i familjes së tij apo saj, ka interes personal apo material.

38.2 Çdo anëtar duhet t’i shfaqë të gjitha konfliktet e interesit që lindin në çdonjërin prej mbledhjeve në të cilën është prezent. Çdo këshilltar mund të ofrojë informacione për interesat e anëtarit tjetër.”

Në mungesë të atij veprimi, kërkoj nga ju shqyrtimin e vendimit dhe po ashtu rekomandoj që për personat në fjalë të kërkohet edhe interpretimi i Agjencisë Kundër Korrupsionit, sa i përket konfliktit të interesit.

Merita Surkishi - është aktualisht punëtore e kompanisë Pastrimi, për të cilën është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Abit Kastrati - Kompania, pronar si së cilës është Kastrati dhe po ashtu edhe drejtor, në momentin e votimit ishte në lidhje kontraktuale me Kompaninë Pastrimi për të cilën është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre

Sami Hamiti - Vëllai i gruas së Z. Hamiti është anëtar bordi në kompaninë Stacioni i Autobusëve Prishtinë, për të cilën është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1 e kësaj letre.

Vlora Dumoshi – Motra e Znj. Dumoshi ka qenë anëtare e bordit të kompanisë Trafiku Urban. Është shkarkuar nga aksionarët e Kuvendit dhe ky shkarkim ka qenë një ndër arsyet pse është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Flamur Shala – Vëllai i Z. Shala ka qenë anëtar i bordit të kompanisë Hortikultura. Është shkarkuar nga aksionarët e Kuvendit dhe ky shkarkim ka qenë një ndër arsyet pse është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Ajnishahe Azemi – Djali i Znj. Azemi ka qenë anëtar i bordit të kompanisë Termokosi dhe i punësuar në ndërmarrjen Publike Banesore. Të dyja këto ndërmarrje janë diskutuar dhe janë marrë vendime në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Shaip Hajrizi – I biri i Z. Hajrizi është i punësuar në kompaninë Hortikultura për të cilën është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes. Po ashtu, kemi informata se i njëjti vazhdon të merr dy paga nga sektori publik edhe pse është ngritur kjo çështje nga Agjencia më herët. Për ndërmarrjen Hortikultura është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Halim Halimi – Vajza e Z. Halimi është e punësuar në Ndërmarrjen Publike Banesore, ndërmarrje për të cilën është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Agim Gashi – Motra e Z. Gashi është e punësuar në ndërmarrjen Hortikultura, ndërmarrje për të cilën është diskutuar dhe është marrë vendim në vazhdimin e mbledhjes së kontestuar nga pika 1. e kësaj letre.

Rrjedhimisht, duke qenë se asnjë nga hapat e lartëcekur procedural të kushtëzuara me Ligjin 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik, nuk është ndërmarrë, jeni të obliguar që në bazë të nenit 58, pika k të shqyrtoni vendimet që pretendohen të jenë marrë pas orës 14:00 kur janë mbledhur grupet e këshilltarëve të cekur më lartë.

Singerisht,

Shpend Ahmeti

Kryetar i Komunës së Prishtinës

